



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 840/14 Prot.

Pogradec, më 26.02.2026

VENDIM

NR. 19, DATË 25.02.2026

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 29.01.2026 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 29.01.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 29.01.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 22 vota

2.Vota Pro 22

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 25.02.2026

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01.2026

ORA : 12:00

JANË PREZENT 21 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 29.01.2026 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të datës 26.12.2025.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës
4. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e kriterëve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2026.
5. **Projekt – Vendim:**Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin dhjetor 2025.
6. **Projekt – Vendim:** Ndryshimin e vendimit nr.127 datë 22.12.2025, Për miratimin e Tavanëve Përfundimtare Buxhetore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (faza III) për vitet 2026-2028 të Bashkisë Pogradec.
7. **Projekt – Vendim:** “Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe të Buxhetit Vjetor 2027”.
8. **Projekt – Vendim:**Për një shtesë në VKB NR 128 datë 22.12.2025 “Detajimi dhe miratimi I buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Pogradec”
9. **Projekt – Vendim:** Miratimin e tarifave të administrimit nga shoqëria Pogradeci Invest Shpk, të ndërtesave ne bashkëpronësi, për vitin 2026.
10. **Projekt – Vendim:**Miratimin e tarifave të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk, për vitin 2026.



11. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare familjes Përparim Beshello, fshati Guras, NJ.A Buçimas, Bashkia Pogradec për rënien e zjarrit ne banese e tij

12. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare familjes Xhemile Selko, fshati Piskupat, NJ.A. Hudenisht, Bashkia Pogradec për rënien e zjarrit në banesën e saj.

13. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Agron Lipo, Lagjia 4, Bashkia Pogradec për shkak të rrëshqitjes së banesës së tij.

14. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 145 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Beqir Rusi, familje që ka pësuar dëme në orendi, pajisje dhe te anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes ne banesë”.

15. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 144 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z.Idajet Rusi, familje që ka pësuar dëme në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake dhe në ndërtim si pasojë e përmbytjes”

16. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 148 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Rudi Tollozhina, familje që ka pësuar dëme në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve”.

17. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në Vendimin Nr. 85, datë 19.10.2021 “Për miratimin e orareve dhe stacioneve në linjën rrethqytetëse Guras – Pogradec - Guras”.

18. Raporti Vjetor I Performancës se Keshillit Bashkiak për vitin 2025 .

19. Të tjera.



1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

Znj.Manjola Kamolli (Kryetare e Keshillit) : Përshendetje , sot jemi mbledhur në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Materialet janë dërguar në mënyrë elektronike dhe në hard copy.Fillojmë me prezencën.

Pa humbur kohë po vazhdojmë me rendin e ditës. Kemi tre projekt – vendime shtesë, dy erdhën dje me e-mail dhe një erdhi sot. Këto projekt – vendime do të hidhen një për një në votim.

Diskutime

Projekt –Vendimi : Miratimin e raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave në bashkinë Pogradec për vitin 2027-2029. Ky projekt – vendim duhet të miratohet në Janar të 2026.

Projekt –Vendimi : Per miratimin e pagës minimale në Bashkinë Pogradec dhe ndërmarjeve në varësi.

Projekt –Vendimi : Një ndryshim në vendimin nr 128 dt 22.12.2025, “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026”

Atëhere po e hedhim në votim, projekt – vendimet.

-Projekt –Vendimi : Miratimin e raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave në bashkinë Pogradec për vitin 2027-2029. Ky projekt – vendim duhet të miratohet në Janar të 2026. **Miratohet pet futjen ne Rendin e Ditës me 20 vota Pro, 1 Abstenim (E. Mancellari)**

- Projekt –Vendimi : Per miratimin e pagës minimale në Bashkinë Pogradec dhe ndërmarjeve në varësi. **Miratohet pet futjen ne Rendin e Ditës me 20 vota Pro, 1 Abstenim (E. Mancellari)**

- Projekt –Vendimi : Një ndryshim në vendimin nr 128 dt 22.12.2025, “Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026” . **Miratohet pet futjen ne Rendin e Ditës me 21 vota Pro,**



Projekt - Vendimet nr 10 dhe 11 kanë të bëjnë me tarifa ,me vendim të Kryesisë edhe të Komisioneve dje kalojnë për Konsultim Publik.

Hedhim në votim Axhendën me Rendin e ditës me heqjen e pikës 9 dhe 10 , duke shtuar tre projekt-vendimet si më sipër.

Kush është dakort?

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 1 (Ervin Mancellari,)

Miratohet **Po** **Jo**

Hyrjet me vonesë të Këshilltarëve

M.Biba: 12:07

E.Mancellari: 12:13

A.Male: 12:16

M.Shuli: 12:11

D.Qeva: 12:16



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01. 2029

3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.

Diskutim !

Znj.M.Kamolli: Ju lutem kush nga ju mund të ketë konflikt interesi të drejtpërdrejtë me pikat e rendit të ditës ju lutem ta deklarojë. Vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës.



4. Projekt – Vendim: Për miratimin e kritereve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2026.

Diskutim!

Znj.M.Kamolli: Sipas ligjit njëherë në vit e hedhim në votim për miratim. Ju lutem ja japim fjalën Znj. Mancellari.

Znj.Mancellari : Përfituesit nga fondi 6% I bllok – ndihmës ekonomike do të përzgjidhen nga familjet aplikuese për ndihmën ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik I ndihmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme, pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme për të jetuar. Duhet të plotësojnë disa kritere.

Fondi që do të përdoret është 6% e fondit faktik që celet cdo 2 muaj për përfituesit e ndihmës ekonomike të përzgjedhura nga sistemi I pikëzimit.

Znj.M.Kamolli: Ka pyetje, e hedhim në votim ju lutem!

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet **Po** **Jo**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01.2026

Znj.M.Kamolli: Do më lejoni për transparencë tju lexoj konfirmimet e Prefekturës.

Znj Kryetare lexon konfirmimet e ardhura nga Institucioni I Prefektit të Qarkut Korçë për mbledhjen e datës 22.12.2025 dhe mbledhjes së datës 26.12.2025.

A handwritten signature in black ink, appearing to be the name 'J. B.', located in the bottom right corner of the page.

Vazhdojmë atëhere me projekt – vendimin e rradhës.

5. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin dhjetor 2025.

Diskutim!

Znj.M.Kamolli: Ja japim fjalën Specialistes.

Znj.Mancellari : Trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% I fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2025 gjithsej 179 familje me fond 737204 lek. Të ndara sipas Njësive Administrative . Krahasuar nga muaji I mëparshëm janë 5 familje më pak për shkak të daljes në pension.

Znj.M.Kamolli: Atëherë nëse nuka ka dicka për të diskutuar, e hedhim në votim ju lutem!

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01.2026

6. Projekt – Vendim: Ndryshimin e vendimit nr.127 datë 22.12.2025, Për miratimin e Tavanëve Përfundimtare Buxhetore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (faza III) për vitet 2026-2028 të Bashkisë Pogradec.

Diskutim!

Znj.M.Kamolli: Ja japim fjalën Drejtoreshës së Financave, znj I. Karapanca.

Znj.Irsa: Duke u nisur edhe nga shkresa që ka dërguar Prefektura, vendimin 127 e kemi kthyer për rishqyrtim për shkak ku gjatë muajit Dhjetor duke vazhduar edhe gjatë muajit Janar, shumë nga ju duhet ta dinë që sistemet kanë patur disa probleme edhe sistemet tona financiare kanë patur disa probleme, për këtë arsye ne nuk mundëm dot të bënim disa ndryshime. Për muajin Dhjetor ne kemi bërë disa ndryshime në të ardhurat ashtu sic ishte Taksa në Infrastrukturë, nuk mundeshim dot që ta pasqyronim në sistem duke qënë ku afati I dorzimit të PBA ishte muaji Dhjetor. Nxorëm nga sistemi ashtu sic na dilte muaji Dhjetor pa vendosur ndryshimet. Duke folur edhe me Juristët e Prefekturës ramë dakort ku do rikthejmë përsëri për shqyrtim PBA për vitin 2026 ti hedhim edhe njëherë në sistem të bëjmë të mundur ndryshimet. Ndryshimi do bëhet vetëm tek të ardhurat ne PBA edhe për ta sjellë edhe njëherë për miratim.

Znj.M.Kamolli: Ka ndonjë pyetje, e hedhim në votim ju lutem !

Largohet: E.Mancellari 12: 28

Rikthehet : E.Mancellari 12:30

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 3 (A.Male, A.Prifti , D.Qeva)

Miratohet Po **JO**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01. 2025

7. Projekt – Vendim: “Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe të Buxhetit Vjetor 2027”.

Diskutim!

Znj Kryetare : Ja japim fjalën Drejtoreshës.

Znj.Irsa: Kalendarit ka të bëjë me hapat që ne duhet të ndjekim gjatë Vitit 2026 për miratimin e PBA 2027 – 2029 , është I njëjti calendar, janë të njëjtat afate.

Znj.Kryetare: Jemi dakort e hedhim në votim!

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



8. Projekt – Vendim: Për një shtesë në VKB NR 128 datë 22.12.2025 “Detajimi dhe miratimi I buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Pogradec”

Diskutim!

Znj.Irsa: Ky grant ju akordohet Bashkive në bazë të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga Ministria. Çdo document ka patur një perëndje të caktuar të vlerësimit të cilat më pas do të mbidhen dhe do të llogaritet fondi për çdo Bashki. Përqindjen më të lartë të e kishte Plani i hartimit dhe mbarështimit të pyjeve dhe dokumntat e tjerë që kërkoheshin ishin Plani i barazisë Gjinore, Plani i Arsimit Parauniversitar, treguesit e matjes së Sistemit te performancës, niveli i pagesës së borxheve etj. Në bazë të përqindjeve Bashkia Pogradec ka përfituar 9,848,851 lekë.

Për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike të ditëve të fundit, si reshjet e dendura të shiut, përmbytjet lokale dhe vështirësitë në qarkullim, është evidentuar nevoja e shtuar për ndërhyrje të shpejtë dhe të vazhdueshme nga ana e shërbimeve tona. Mjetet aktuale në dispozicion janë të pamjaftueshme dhe në disa raste të papërshtatshme për përballimin e situatave të krijuara, duke sjellë vonesa në kryerjen e detyrave dhe kufizim të shërbimit ndaj qytetarëve. Përballë këtyre kushteve, sigurimi i 2 (dy) mjeteve motorike shtesë është i domosdoshëm për garantimin e ndërhyrjeve në kohë, lëvizshmërisë dhe vijueshmërisë së shërbimeve. Për më shumë po ja jap fjalën z.Torra për të folur më shumë për situatën.

Z.Torra:Përhëndetje! Në bazë të situatës të rënduar që ne kaluam e pamë të domosdoshme paisjen me dy kamiona . Ne kemi në punë fadromat por e kemi të domosdoshme për rastet emergjente janë domosdoshmëri. Ku ato do të përdoren edhe për rrugët në zonat e thella ku kemi domosdoshmëri ndërhyrjen sidomos për rrugët sekondare. Menduam bashkangjitur fadromave të jenë edhe këto. Ku këto mjete të mos jenë vetëm për të shtyrë por edhe ti ngarkojmë edhe ti shkarkojmë. Në lidhje me fondet do ti ketë Ndërrmarja e Mirmbajtjes ku është bërë edhe një hulumtim tregu.

Znj.Biba: Janë gjetur mjetet?

Znj.Irsa: Jo studiojmë tregun në fillim.

Znj.Kryetare: Kemi dicka?

Z.Pikuli:Sa kapacitete kanë kamionat?



Znj.Eni: Përshëndetje! Unë jam Juriste dhe nuk mund tju shpjegoj kapacitetin e kamionave, por di të them me tre akse edhe me katër akse detajet që unë kam parë në treg. Pjesën tjetër do ta përcaktojnë teknikët ose inxhinierët. Ne mund të themi që është e nevojshme realisht.

Zn.Kryetare: Ju lutem flisni me rradhë.

Z.Male: Duhet të vijnë personat përkatës për sqarrime ku të dimë edhe ne se për çfarë bëhet fjalë.

Znj.Eni: Unë kam bërë një relacion për shkak të kushteve të emergjencës ku ne jemi ndodhur.

Znj.Kryetare: Kërkohet detajimi, kemi ndokënd që mund të na përgjigjet?

Z.Torra: Të theksojmë dikça, kamionët do jenë me tre akse ashtu sic ne kemi kamionin, specifikimet teknike faktikisht se si ato do jenë do përcaktohen me dokumenta, thjesht tani caktohet fondi edhe në bazë të atij fondi do të përcaktohen edhe kamionët.

Znj.Biba: Detajimi?

Znj.Topa: Nuk po votojmë detajimin.

Z.Torra: Ne nuk po përcaktojmë specifikimet e kamionit, ne po miratojmë buxhetin jo kamionin.

Znj.Shuli: Duke u bazuar tek rastet e fundit të përmbytjeve në Pogradec, mendoj që është tepër emergjente blerja e këtyre dy makinave. Nuk mendoj që është kaq e rëndësishme mbi tonazhin e makinave, e rëndësishme është të blihet edhe të jetë në kohën e duhur.

Z.Mancellari: Parimisht unë jam shumë dakort, do bëja një sugjerim të meren informacionet e detajuara për të punuar kamionët edhe jo të ngelen të parkuara.

Z.Pikuli: Janë dy metoda të rëndësishme ku e para ka të bëjë të kemi disa referenca për kamionët, kurse tjetra është sa lek duhen të blejnë kamionin. Na thoni nga e kaluara nga eksperinca do meren 10 ton, 20 ton edhe ne duhet ta dimë si do jenë, sa do jenë.



Znj.Topa: Sot me sa kuptoj unë janë fituar disa lek dhe do shpenzohen në këtë mënyrë, me thënë të drejtën me aq sa di unë kuptoj që është procedurë tenderimi.

Z.Pikuli: Dua të di me këto dy kamionat do bëhet apo jo.

Znj.Topa : Ne po miratojmë aktualisht që do përdoren për këtë arsyeje, kur të vij momenti I blerjes do kërkohen këto informacione.

Z.Pikuli: Nuk e kërkojmë këtë dokumentacion se problem është I thjeshtë, ai që bëri prezantimin mund të thotë nga eksperiencia na duhen këto kamionë.

Znj.Topa: Prezantimi vjen nga financa. Kur të vijë momenti .

Z.Pikuli: Ajo që u tha, për sa kohë do ti përdorim, sa do jetë koe ficienti I përdorimit.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim ju lutem !

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 4 (D.Qeva, M. Biba, F. Pikuli, A.Male)

Miratohet **Po** **Jo**



9. Projekt – Vendim: Për dhënie e ndihmës financiare familjes Përparim Beshello, fshati Guras, NJ.A Buçimas, Bashkia Pogradec për rënie e zjarrit ne banese e tij

Diskutime

M.Kamolli: Ja japim fjalën Z.Nexho, ju lutem!

Z.Torra: I gjithë dokumentacioni është vënë në dispozicionin tuaj, në Dhjetor të 2025 ka ndodhur një zjarr në fshatin Gurras, është njoftuar salla operative edhe zjarrfiksia. Sipas procedurës që ne duhet të ndjekim ne presim ku zjarrfiksia dhe sektori I zjarrit të sjellin raportin, ku ne të shohim dëmet që kanë ndodhur, ku ne bëjmë konstatimet edhe vlerësimet. Në rastin konkret dëmi ka ndodhur në orenditë shtëpiake. Vlera e orendive vlerësohet 100%, kurse në ndërtim edhe në infrastrukturë paguhet 50%. Në rastin konkret kemi vetëm dëm në orendi.

Znj.Kryetare: Kemi pyetje ju lutem!

Z.Male: Zakonisht këtyre familjeve kur ju jepet shuma, ju jepet në vlerë monetare apo ju e bëni me Prokurim nga Bashkia?

Z.Torra: Në cdo rast ne japim vlerën monetare edhe familjarët I bëjnë vetë shërbimet. I kalojnë në llogari individit që I ka ndodhur fatkeqësia.

Z.Male: Më pas ju bëni ndonjë verifikim?

Z.Torra: Patjetërr ne deri sat ë bëjmë verifikimin paraprak, në verifikimin e dytë janë dëmtuar janë hedhur, jo se kemi patur ndonjë konstatim.

Z.Biba: Në këto raste kur janë bërë konstatimet e para nuk mund të pyesim. Thjesht mund të siguroheni që dokumentacioni është I saktë edhe I rregullt.

Z.Male: Jemi në këtë Drejtori mund të p yes dicka?

Znj.Kryetare: Ka lidhje me temën?

Z.Male:Kësaj Drejtorie I përket.



Znj.Kryetare: Ju lutem mos dalim nga rendi I ditës, nga mbledhja nuk do largohet as edhe një de ri në fund, ku do të bëhen diskutimet përkatëse.

Z.Male: Shkurtimisht ka shumë familje ku janë dëmtuar para dy vjetësh edhe akoma nuk janë marë dëmshpërblimet?

Z.Torra: Kjo është një problematikë ku ne si Bashki jemi në dijeni, na ka ndodhur me subjektin zbatues është lidhur edhe kontratat janë bërë edhe procedurat. Sot në kushtet që jemi subjekti nuk I ka mbaruar.

Znj.Kryetare: Në rregull I morëm sqarimet përkatëse, vazhdojmë ju lutem!

Z.Torra: Për ato katër persona që ti përmënde ne kemi ngritur një grup zbatues, po bëhet verifikimi në këto objekte.

Z.Kryetare: Faleminderit Z. Torra vazhdojmë.

Znj.Prifti: Ka edhe persona të tjerrë.

Z.Kryetare: Po flasin për një person ju lutem.

Znj.Prifti: Kemi shumën e akorduar, kjo shumë është shumë e vogël, unë dua të di kjo shumë vjen e përcaktuar nga Ministria apo e keni bërë ju si Bashki.

Mund të rritet kjo shumë, se banorët deklarojnë që si përballojnë dot.

Z.Torra: Në munual është e përcaktuar, nuk mund ta ndërrojmë.

Znj.Kryetare: E kalojmë në votim ju lutem kush është dakort.

U votua

Pro 24 vota

Kundër 0 vota

Abstenim 0 vota

Miratohet Po Jo



10. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare familjes Xhemile Selko, fshati Piskupat, NJ.A. Hudenisht, Bashkia Pogradec për rënien e zjarrit në banesën e saj.

Diskutim!

Z.Torra : Është e njëjta situatë, ndryshon ku dëmtimi është vetëm nga ana ndërtimore dhe vlera që akordohet është 50%.

Z.Mancellari: Mund të rritet kjo vlere, për cdo rast bëhet gjykim më vete, mund tju shtohet vlera?

Znj. Kryetare : Nqs nuk keni dicka për të shtuar e hedhim në votim pikën 10 të rendit të ditës.

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01.2026

11. Projekt – Vendim: Për dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Agron Lipo, Lagjia 4, Bashkia Pogradec për shkak të rrëshqitjes së banesës së tij.

Diskutim!

Z.Torra: Ky është rast tjetër nuk ka zjarrin por ka rrëshqitjet, në rastet ku ne kemi rrëshqitje ja japim institutit të ndërtimit, ku ata shprehen ky objekt është I banueshëm ose jo.

Znj. Kryetare : Hedhim në votim pikën nr 11 të rendit të ditës.

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



12. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 145 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Beqir Rusi, familje që ka pësuar dëme në orendi, pajisje dhe te anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes ne banesë”.

Diskutim:

Znj.Kryetare: Vlerat që ne kishim në dispozicion janë kthyer nga Prefekti për ndryshim edhe plotësim dokumentacioni. Ajo që unë kërkova dje ishte që të shprehej në Relacion se ku qëndronte ndryshimi.

Z.Torra:Familja e Z.Rusi kishte nevojë për plotësim dokumentacioni, ne ja plotësuam edhe dokumentacionin edhe në relacionin e ri vendosëm të gjitha kërkesat që u kërkua nga Prefektura.

M.Kamolli: Hedhim në votim pikën 12 të rendit të ditës.

Largohet: Z.Pikuli 12:52

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01. 2026

13. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 144 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z.Idajet Rusi, familje që ka pësuar dëme në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake dhe në ndërtim si pasojë e përmbytjes”

Diskutim:

Znj. Kryetare: Është e njëjta situatë për plotësim dokumentacioni.

Z.Torra: Shifrat nuk përputheshin.

Znj.Kryetare : Hedhim në votim pikën 13 të rendit të ditës.

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po **JO**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01. 2026

14. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB nr 148 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Rudi Tollozhina, familje që ka pësuar dëme në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve”.

Diskutim:

Z.Torra: Në rastin konkret, kemi shënuar edhe disa paisje si orendi shtëpijake (një pompë për të pastruar makina, matrapik) këto nuk mund të merreshin për konsideratë, nuk janë në manual si orendi shtëpijake.

Znj.Kryetare : Hedhim në votim pikën 14 të rendit të ditës.

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



15. Projekt – Vendim: Për një ndryshim në Vendimin Nr. 85, datë 19.10.2021 “Për miratimin e orareve dhe stacioneve në linjën rrethqytetëse Guras – Pogradec - Guras”.

Diskutim:

Znj.Kryetare: Këtu është zhvilluar edhe Konsultimi Publik, faleminderit kolegëve që morën pjesë. Do ju lutesha që të kemi më shumë pjesëmarrje në Konsultimet Publike.

Z.Shtupa: Është një vendim përsëritës, shtohet një orar edhe do të shërbejë për periudhën 1 Qershor deri në 31 Gusht. Në projekt – vendimin e parë ishin oraret mbas orës 17 dhe mbas dëgjësës publike që u zhvillua në fshatin Gurras ramë dakort për oraret që ne ju kemi paraqitur në projekt- vendimin e rradhës.

Znj.Kryetare : Po jemi shumë të qartë lexuam edhe procesverbalin ku ishte I bashkangjitur, kemi ndonjë pyetje?

Hedhim në votim pikën 15 të rendit të ditës.

U votua

Pro 22

Kundër 1 (K.Gjona)

Abstenim 0

Miratohet Po JO



16. Raporti Vjetor I Performancës se Keshillit Bashkiak për vitin 2025 .

Diskutim:

Znj.Pilinci: Ky është një projekt-vendim bazuar në nenin 84, ku është I përcaktuar ku brënda Janarit ne duhet të miratojmë hartat parashikuese për tre vitet e ardhshme, ju kërkojmë ndjesë për vonesën. Ne vitin e kaluar projekt-vendimin ne e bënim bashkë me Drejtorinë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar. Parashikimi për tre vitet e ardhshme ku bazohet në vendimin aktual që ne kemi dhe me të dhënat për numrin e bizneseve dhe numrin e familjeve planifikuar për 2026 me një ritje të vogël. Duke parë ritjen e bizneseve nga Viti në Vit ku shkon nga tetë deri në dhjetë biznese më tepër dhe numrin e familjeve duke parë shtrirjen e Ujsjellësit deri në zonat e thella. Është një parashikim ku mund të ndryshojë në rastin ku mund të kemi një ndryshim në ligj , një ndryshim në projekt – vendim do pasqyrohet në vitet e ardhshme.

Znj.Kryetare: Kemi pyetje, atëhere e hedhim në votim?

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet **Po** **Jo**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01. 2025

17. Per miratimin e pagës minimale në Bashkinë Pogradec dhe ndërmarjeve në varësi.

Diskutim:

Znj.Elmasllari: Vijnë me një projekt- vendim me ndryshim të pagës minimale të Bashkisë Pogradec edhe ndërmarjeve në varësi ku përfitojnë 330 punonjës ku paga minimale nga 40 mijë kalon në 50 mijë të reja edhe këto do përballohen nga buxheti I Bashkisë.

Znj.Prifti: Nuk është moment tani, por kjo është e padiskutueshme që do bëhet, ne vitin e kaluar ku ishte edhe Kryetari I Bashkisë në mbledhje u diskutuar që do rishqyrtohen pagat e punonjësve , kemi kaq kohë ku ky rishqyrtim është në heshtje dhe ne nuk kemi marrë një përgjigje. Unë e shikoj si dicka ku është lënë mënjanë, sepse ka disnivele shumë të mëdha. Ne e kemi parë projekt- vendimin edhe e kemi miratuar.

Znj.Elmasllari: Do e shqyrtojmë dhe do ju vendosim në dijëni.

Znj. Kryetare:E hedhim në votim ju lutem, kush është dakort..

Largohet: E.Mancellari 13:04

U votua

Pro 21

Kundër 1 (D.Qeva)

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 29.01.2026

18. Për një ndryshim në vendimin nr 128 dt 22.12.2025, "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"

Diskutim:

Znj.Irsa: Ju kërkoj ndjesë për vonesën duke e sjellë një orë para mbledhje, na ka lindur dicka e nevojshme për të bërë një ndryshim në buxhet. Ndryshimi që do bëhet do të jetë pakësimi nga fondet për likuidimin e objektit në rrugën e Zëmcës ku është miratuar edhe e kemi për likuidim ku do të krijohet një object I ri I cili është përfundimi I Kopshtit L.Como.

Z.Ziko: Pse na lindi nevoja edhe pse është emergjente, punimet janë duke u zbatuar tek objekti, ka qënë një projekt ku ne e kemi marë nga Ministrija e Arsimit. Projekti është bërë me aq Buxhet sa ka pasur Ministria. Ne duhet ta rishikonim për ta përfunduar atë me të gjitha standartet, ku mos ti kthehemi për herë të dytë. Do jetë një kontratë e re dhe një procedurë e re. Menduam të shlyejmë më pak lek tek rruga e Zëmcës për të përfunduar kopshtin brënda afatit.

Znj.Biba: Pyetje nuk kemi , por kjo është kur ne miratojmë buxhetin duhet të jenë më të detajuara.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim ju lutem kush është dakort?

Rikthehet: E.Mancellari 13:06

Largohet: E.Shyti 13:08

U votua

Pro 23

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Znj.Kryetare: Kemi Raportin Vjetor të Performancës së Këshillit Bashkiak për Vitin 2025.

Sekretarja e Këshillit: Lexon Raportin Vjetor.

Znj.Kryetare: Faleminderit Kolegë, vazhdojmë me pika të tjera. Para se të fillojmë dua tju informoj për dicka që u diskutua ditën e djeshme në Komisionet, ishte prezent Z.Cela Drejtor I Pogradec Invest. U diskutua pjesa e rritjes së pagesave të cilat do ti keni në Konsultim Publik, do ju lutesha kur të dali data e konsultimi public të lajmërohen banorët dhe bizneset, sigurisht duhet të jeni edhe ju prezent. Ne kërkuam sepse e dimë që është shqetësim për të gjithë pjesa e parkimeve, ju kërkuam do e dërgojmë edhe me shkresë të na paraqitet një raport.

Znj.Klea: Ne e kemi miratuar në Këshill.

Diskutim:

Z.Male: Në Janar të 2025 u fut në Këshill dhe u miratua, u kthye nga Prefektura dhe u diskutua që do rifutet edhe njëherë. Nuk e keni sjellë më. Kush është arsyeja, duke dëgjur edhe nga konsultimet jemi Bashkia me nivelin më të ulët të pagave. Pse nuk është bërë?

Znj.Elmasllari: Kurt a shohim të arsyeshme do e sjellim.

Z.Male: Është hera e dytë që marr të njëjtën përgjigje, ju jeni specialistët e fushës edhe duhet të keni një përgjigje.

Znj.Prifti: Nuk është argument ky që ju po jepni, nuk e kemi parë të arsyeshme.

Znj.Kryetare: Me rradhë ju lutem.

Znj.Elmasllari: Kur të vijë indeksimi I pagave do ketë një ritje, absolutisht që po. Jemi në fillim të vitit do bëhet analiza e punës, aty do shikojmë arsyen se kush nga specialistët përfitojnë rritje.

Z.Male: Kur u bë pyetja ishte I parashikuar Buxheti, u kthye nga Prefekti.

Znj.Elmasllari: Nuk ishte e parashikuar.

Z.Male: Ishte e parashikuar sepse ne e miratuam në Këshill.

Z.Elmasllari: Miratuam të Dhjetorit.

Z.Male: U la që do e sjellim këtë vit prap për miratim, ne patëm shumë diskutime kur ndodhi ndryshimi I nivelit të pagave midis Drejtorëve edhe Specialistëve, prandaj u soll ai projekt- vendim, e ktheu Prefekti ku nuk diskutua më, mar të njëjtën përgjigje për herë të dytë.

Znj.Irsa: Prap të njëjtën përgjigje do kesh.

Z.Male: Vlerësoini punonjësit sepse edhe ata që keni do ju ikin, përgjigja e juaj është shumë e ftohtë.

Znj.Irsa: Ishit ju Z.Arbër ku muajin e parë u ankuat për punonjësit ku disa vijnë disa nuk vijnë edhe jeni ju ku këtë muaj po thoni vlerësoini se do ju ikin.

Z.Male: Jam I shqetësuar për ata që punojnë, ata që nuk punojnë le të largohen për këtë arsye. Ne ju themi ulni numrin e punonjësve edhe ju bëni të kundërtën.

Znj.Irsa: Ne jemi munduar ku të gjithë punonjësit ti trajtojmë ashtu sic duhet.

Znj.Topa: Jo për të dalë në mbështetje të Arbitrit por po ju a bëj të qartë se ndoshta është harruar. Nuk po diskutojmë për rritjen e pagave sepse ajo është ligj edhe nuk diskutohet, është thënë kur të mbarojnë zgjedhjet do rifuteshe edhe njëherë, unë e shoh më shumë se sa e arsyeshme është një problem financiar që e con në mosrritjen e pagave.

Znj.Elmasllari: Kjo është për sa kohë ne themi që nuk e shikojmë të arsyeshme.

Znj.Topa: Nuk do merremi me pjesën e ikjes atë e tregon puna edhe pse Specialistët vijnë edhe kërkojnë rritje page është e logjikshme edhe kjo, numri I punonjësve të Bashkisë Pogradec nuk është më I lartë se Bashkitë e tjerra. Mund të themi që pot ë ishte në një nivel më të ulët edhe pagat do ishin më të larta. Për rritjen e pagave është një diskutim ku uk duhet marrë personale, është një diskutim që do bëhet gjithmonë, gjithmonë do ketë pakënaqësira.

Z.Mancellari: Sa për pjesën e rritjeve të pagave, ndoshta ju nuk keni qënë prezent, kur ka erdhur miratimi me vendimin e Qeverisë ku disnivele ishte shumë I madh ku kishte Drejtorë ku paga e tyre ishte trefishi I specialistëve. Kemi diskutuar me Kryetarin e Bashkisë edhe është thënë me urdhër të tij, të shqyrtohen edhe njëherë.



Kjo është arsyeja se pse ne po e diskutojmë, nuk ishte as ai dakort me këtë nivel. Ju lutem shumë të meren parasysh. Faleminderit!

Znj.Irsa: Unë personalisht kam qënë në cdo mbledhje, kam qënë edhe tek mbledhja e rritjes së pagave dhe normalisht nivelin nuk e rritsim dot, janë afër nivelit maksimal të gjithë.

Z.Gjona:Ku është parë të diskutohet një projekt-vendim pasi është miratuar.

Znj.Kryetare: Ky nuk është fare projekt- vendim ,por është shqetësimi I joni. prandaj janë pikat e tjera për të diskutuar.

Z.Gjona:Kush nga këto diskutime që po ndodhin tani nuk është tek Rendi I ditës, është pjesë e pagës nuk dalim nga rendi I fjalës. Këto janë shkelje të procedurës.

Znj.Kryetare: Unë nuk kam bërë as një shkelje të procedurës këtu nuk ka lidhje me Bashkitë e Forta.

Z.Gjona: Nuk ka ku ptim që të diskutohet një projekt-vendim pasi është miratuar.

Znj.Kryetare: Ky nuk është projekt – vendim. Paga minimale ka ardhur me VKM ky është projekt- vendimi që ne kemi në rendin e ditës. Në këto moment ne po flasim për rritje progresive të pagës, po flasim për të gjitha ato shqetësime që I kemi ngritur edhe herë të tjera. Nuk dua të prishim rendin e ditës.

Znj.Topa: Ky projekt-vendim ka të bëjë me pagën minimale, kurse ky shqetësim që u ngrit nga Arbëri me të drejtë është dicka tjetër.

Z.Gjona: Cdo Këshilltar ka të drejtë të flasi dy minuta. Ne po diskutojmë për pagën

Z.Haxhillari:Unë përgjithësisht pajtohem me të gjitha shqetësimet e Anëtarëve të Kishillit edhe me shqetësimin e pagave që duhet të bëhet sepse krijohet një problem me rritjen e pagës minimale, këtu del që punonjësit vendosen në një nivel. Eshtë detyrë patjetër e Këshillit të shikojnë akordimin e të gjithë punonjësve. Nëse ka mundësi të bëhet shtesë në pagat në kufirin minimal edhe maksimal të lejuar, nuk po diskutohet që të kalohet në atë nivel, por mbrënda nivelit duhet bërë përpjekje sepse pagat gjithmonë kanë mundësi për të rregulluar.



Znj.Prifti: Ky disnivel nuk është miratuar nga VKM, sepse do na dali paga minimale më lartë. Është një shqetësim I përgjithshëm.

Znj.Biba:Ky është një shqetësim me të drejtë, kemi bërë shumë debat kur është miratuar, përgjigja e juaj është e palejueshme, ke mundësi të bësh ndryshime të përshtasës nivelet, nëse ju vendosni disa kriteret të përcaktuara nuk do të keni këtë ndryshim edhe nuk do të keni këtë padrejtësi. Kriteret I dini ju, kemi rënë dakort për këtë pjesë.

Znj.Elmasllari:E kemi bërë të qartë, por prap ka pakënaqësira. Pirpiqemi gjithmonë të shpjegojmë këtë pjesë.

Znj.Biba: Nuk duhet të duket kjo diferencë e madhe.

Z.Male:Kemi me një ngritje abusive nga cmimi që është miratuar tek ne.

Znj.Pllaha: Janë rritur cmimet.

Znj.Kryetare: Duhet kontrolluar.

Nëqoftëse nuk kemi dicka tjetër për të diskutuar mbledhja deklarohet e mbyllur. Ju falenderoj për pjesmarrjen tuaj!

